



01 Nr. 228/25 Dt. 04.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Çelë Lamaj-drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit dhe Defrim Zajmi nga Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën e GIZ-it, për pjesëmarrje në Konferencën Rajonale "Green Transport Solutions", që do të zhvillohet nga data 24 prill 2025 deri me 25 prill 2025, në Ohër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare për pagesë të shpenzimeve të udhëtimit dhe të mëditjeve si dhe për shpenzime të paparashikuara për të lartcekurit.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 23 prill 2025 dhe kthimi me 26 prill 2025.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.